

www.gjykataelarte.gov.al



REVISTA DIGJITALE

DIALOG JURIDIK

REFLEKTIME GJYQËSORE

Paraburgimi si “zgjedhja e parë”: rikthimi te standardi kushtetues dhe konventor i masave të sigurimit

Reflektim parimor mbi individualizimin, proporcionalitetin dhe alternativat ndaj paraburgimit, në dritën e jurisprudencës së GJEDNJ për Shqipërinë

Sokol Sadushi

Kryetar i Gjykatës së Lartë

(Ish-gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese; profesor i së drejtës)

Hyrje:

Paraburgimi është një ndër çështjet më të ndjeshme në një shtet të së drejtës, sepse prek njëkohësisht praktikën gjyqësore të përditshme, politikën penale, perceptimin publik për kriminalitetin dhe raportin me standardet europiane. Mënyra si përdoret paraburgimi shërben si tregues i drejtpërdrejtë i cilësisë së kontrollit gjyqësor mbi lirinë personale, që verifikohet nga niveli i individualizimit të vlerësimit, nga provueshmëria e rrezikut të pretenduar dhe nga zbatimi real i alternativave.

Në Shqipëri, kjo temë merr peshë të veçantë jo vetëm për shkak të ndjeshmërisë shoqërore ndaj kriminalitetit, por edhe sepse standardi i masave të sigurimit është një “provë” e përditshme e funksionimit të shtetit të së drejtës. Kur paraburgimi rritet dhe kthehet në praktikë të zakonshme, nuk kemi vetëm një çështje statistikore, por një sinjal se po dobësohen garancitë e lirisë personale dhe cilësia e arsyetimit gjyqësor. Debat i mbi paraburgimin nuk është debat për tolerancë ndaj kriminalitetit; është debat për rigorozitet ndaj standardit. Theksi, pra, nuk është te retorika “pro” apo “kundër” ashpërsisë, por te kërkesa që kufizimi i lirisë të mbështetet në rrethana konkrete dhe të arsyetohet bindshëm, në funksion të qëllimit të masës dhe alternativave të mundshme.

Në këtë kuptim, kjo analizë mbështetet në tri shtylla: rolin institucional, standardin ndërkombëtar dhe detyrimin akademik. Ajo synon të jetë një reflektim parimor mbi standardin kushtetues e konventor të masave të sigurimit, në dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së dhe të detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësia e Shqipërisë në Këshillin e Evropës, si edhe nga procesi i integritetit në Bashkimin Evropian. Çështjet shtrohen në një plan profesional e qytetar: jo për të “gjykuar” sistemin, as për të komentuar apo paragjykuar çështje konkrete, por për të identifikuar faktorët që ushqejnë nivelin e lartë të paraburgimit, për të propozuar rrugëzgjidhje dhe për të rikujtuar se **liria është rregulli, ndërsa paraburgimi është përjashtimi**.

1. Masat e sigurimit dhe kultura e paraburgimit

Masat e sigurimit personal garantojnë procesin penal: praninë e të dyshuarit, integritetin e provës dhe parandalimin e rreziqeve konkrete. Ato nuk janë dënim paraprak dhe nuk mund të zëvendësojnë efikasitetin e hetimit me izolim. Në këtë kuptim, paraburgimi është kufizimi më i rëndë i lirisë dhe mund të vendoset vetëm kur është realisht i domosdoshëm, i individualizuar e proporcional, dhe kur masat alternative nuk mjaftojnë.

Kur paraburgimi trajtohet si “zgjedhja e parë”, për shkak të presionit publik, komoditetit procedural apo standardizimit të arsyetimit, vihet në rrezik balanca themelore ndërmjet interesit publik dhe të drejtave individuale. Prandaj debati mbi masat e sigurimit nuk është thjesht teknik.

Në thelb, ai është debat për cilësinë e arsyetimit dhe guximin profesional për të vendosur sipas standardit, jo sipas pritshmërive.

2. Pse ky shqetësim kërkon vëmendje të menjëhershme?

Raportet ndërkombëtare për Shqipërinë (Këshilli i Evropës, Bashkimi Evropian dhe mekanizma të OKB-së) kanë sinjalizuar një problem strukturor: niveli i paraburgimit është i lartë dhe shpesh i zgjatur në kohë, duke bërë që të paraburgosurit të përbëjnë mbi gjysmën e popullsisë në burgje.

Sipas të dhënave të publikuara, në dhjetor 2025, raportohej se në burgjet shqiptare ndodheshin 4503 persona, nga të cilët 2569, ose 57%, ishin të paraburgosur në pritje të gjyqimit. Kur mbi gjysma e popullsisë në burgje është ende e pagjykuar, rrezikojmë ta kthejmë përjashtimin në rregull. Kjo përqindje është tregues alarmi: masa “arrest në burg” rrezikon të shndërrohet në një normalitet.

Në praktikë, niveli i lartë i paraburgimit ushqehet nga një rreth vicioz sepse:

- prokuroria priret të kërkojë masën më të rëndë si “garanci” e menjëhershme;
- gjykata, nën tryshninë e kritikës publike ose të riskut reputacional, mund të tundohet drejt zgjidhjes më “të sigurt” në perceptimin publik;
- masat alternative trajtohen formalisht, me një fjali standarde;
- proceset zgjasin; paraburgimi zgjatet dhe arresti fillon të trajtohet si zgjedhja e parë, jo si përjashtim.

Kjo kulturë prodhon dy pasoja të rënda: *së pari*, dobëson prezumimin e pafajësisë në perceptimin publik; *së dyti*, rrit rrezikun e shkeljeve konventore, të shoqëruara me dënime të shtetit dhe ulje të besimit të drejtësisë.

3. Ku qëndron problemi thelbësor?

Debati profesional e ka identifikuar “pikën e dobët”. Problemet shfaqen që në fazën fillestare, kur rreziqet ngrihen shpesh në mënyrë abstrakte (“rrezik ikjeje”, “rrezik prishjeje provash”), pa u lidhur me rrethana konkrete dhe të individualizuara. Kjo ushqehet nga “presioni i jashtëm” dhe “frika” nga pasojat, duke e shtyrë vendimmarrjen drejt logjikës “*më mirë brenda, se mos ndodh diçka...*”. Konventa nuk e njeh këtë qasje si kriter. Ajo kërkon arsyetim të kontrollueshëm, të individualizuar dhe të mbështetur në fakte.

Një pika tjetër e dobët është trajtimi formal i alternativave. Alternativat nuk janë thjesht një referencë formale; ato janë pjesë e testit të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit. Pa një shqyrtim real të tyre, paraburgimi e humb karakterin e përjashtimit.

Problemi i tretë është “inercia”. Me kalimin e kohës, arsyetimi nuk mund të mbetet i pandryshuar; rrethanat zhvillohen, procedimi kalon nga një fazë në tjetrën dhe, për pasojë, barra e arsyetimit rritet. Prandaj çdo zgjatje e paraburgimit duhet të mbështetet në elemente aktuale dhe të

verifikueshme, jo në përsëritjen e të njëjtave formula. Nëse vendimi ripërsëritet me të njëjtat fraza, paraburgimi kthehet në gjendje të zakonshme, jo në masë të justifikuar.

4. Detyrimi kushtetues dhe konventor: çfarë kërkon GJEDNJ nga Shqipëria?

Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut (GJEDNJ) e trajton paraburgimin si masë përjashtimore. Dy vendime të rëndësishme (*Hysa kundër Shqipërisë dhe Gëllçi kundër Shqipërisë*), e vendosin standardin me qartësi: problemi nuk është mungesa e rregullave, por zbatimi në praktikë i individualizimit, proporcionalitetit dhe shqyrtimit real të masave alternative.

Së pari, GJEDNJ vendos gurin e themelit të çdo vendimi për masat e sigurimit. Arsyetueshmëria e paraburgimit “nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte... [por] duhet të vlerësohet mbi faktet e secilës çështje dhe sipas tipareve të saj specifike ...” (*Hysa kundër Shqipërisë*, §66). Kjo do të thotë se nuk mjafton të pretendohet “rreziku i ikjes” apo “rreziku i prishjes së provave”. Vendimi duhet të shpjegojë qartësisht: *Cilat fakte e provojnë rrezikun? Pse rreziku është real në atë rast? Pse ai nuk neutralizohet me masa më pak kufizuese?*

Së dyti, Gjykata e bën të qartë se “dyshimi i arsyeshëm” është vetëm porta hyrëse e paraburgimit dhe jo një justifikim i përhershëm. Në çështjen “*Gëllçi kundër Shqipërisë*” thuhet shprehimisht: “... vazhdimësia e një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, por nuk mjafton më pasi kalon një farë kohe ...”. (§ 19). Mesazhi është i drejtpërdrejtë se paraburgimi nuk mund të vijojë “për inerci”. Me kalimin e kohës, shteti duhet të tregojë arsye të tjera relevante dhe të mjaftueshme, të përditësuara dhe të lidhura me fazën dhe nevojat konkrete të procesit.

Së treti, GJEDNJ godet fenomenin e justifikimit të zgjatjes së paraburgimit me fraza të përgjithshme. Në çështjen “*Gëllçi kundër Shqipërisë*”, gjykatat “...nuk specifikuan provat konkrete që duhej të mbledheshin, si edhe nuk shpjeguan pse ato prova nuk mund të merreshin në një fazë më të hershme të hetimit.” (§ 23). Po aty theksohet se rreziku i manipulimit të provave nuk pranohet automatikisht. Sipas Gjykatës autoritetet “...nuk iu përgjigjën parashtrimeve të kërkuarit që dyshimi kundër tij bazohej në mënyrë ekskluzive mbi dokumente të cilat tashmë ishin sekuestruar nga prokuroria dhe se prandaj nuk ekzistonte rreziku që ai të manipulonte dëshmitarët apo provat e tjera”.

Së katërti, pika më e mprehtë për praktikën shqiptare - GJEDNJ kritikon trajtimin formal të masave të tjera alternative. Në “*Hysa kundër Shqipërisë*” thuhet: “...përveçse një deklaratë formale ... vendimet vendase nuk treguan realisht çfarë peshe u dha masave alternative (§76). Ndërsa në “*Gëllçi kundër Shqipërisë*”, ky konstatim përsëritet në mënyrë të drejtpërdrejtë: “Nuk duket as që ato gjykata kanë vlerësuar siç duhet ndonjë masë sigurimi alternative përtej një deklaratë thjesht formale ...”(§25). Këto dy citime janë “busulla” e çdo reformimi të praktikës: një vendim për paraburgim që përmend alternativat vetëm si frazë standarde, pa analizë reale, është i pambrojtshëm sipas Konventës.

Në këtë kuadër, standardi i Gjykatës së Strasburgut është i drejtpërdrejtë: **(i)** arsyetueshmëria e paraburgimit nuk vlerësohet në mënyrë abstrakte, por mbi fakte konkrete; **(ii)** pas kalimit të një kohe, dyshimi i arsyeshëm nuk mjafton; **(iii)** zgjatja nuk mund të justifikohet me “rreziqe” të përgjithshme pa treguar veprime/prova konkrete që mbeten për t’u kryer dhe pse nuk janë kryer

më herët; dhe **(iv)** alternativat ndaj paraburgimit nuk mund të mbeten një deklaratë formale. Ky është një detyrim i qartë për autoritetet hetimore dhe gjyqësore shqiptare, si pjesë e përgjegjësisë për të garantuar lirinë personale dhe përputhshmërinë me standardet e Këshillit të Evropës.

Në gjuhë të thjeshtë, kjo do të thotë se vendimi duhet t'i përgjigjet qartë katër pyetjeve: *Çfarë rreziku konkret ekziston? Mbi cilat fakte mbështetet? Pse është aktual? Pse nuk neutralizohet me masa më pak kufizuese?*

5. Shkaqet e paraburgimit të lartë: problem zinxhir, jo faj i një institucioni

Fenomeni i paraburgimit të lartë nuk mund të shpjegohet me një aktor të vetëm. Ai është problem i një zinxhiri, ku secila hallkë ndikon mbi tjetrën.

Së pari, politika penale ka shfaqur prirje ashpërsimi dhe zgjerim të fushës së veprave penale, që rrit volumin e çështjeve dhe nxit kërkesat për masa më të rënda sigurie;

Së dyti, vonesat në hetim dhe gjykim e zgjatin paraburgimin dhe e kthejnë masën e përjashtimit në gjendje të zakonshme;

Së treti, presioni publik dhe frika nga pasojat (arratisje, përsëritje e veprës, ose reagim mediatik) mund të krijojnë prirjen, që vendimmarrja të orientohet nga nevoja për të shmangur çdo kritikë a përgjegjësi publike, më shumë sesa nga analiza e provave dhe zbatimi rigoroz i standardit të individualizimit dhe proporcionalitetit;

Së katërti, mungesa e infrastrukturës funksionale të masave alternative (monitorim real, mekanizma kontrolli, koordinim) e bën paraburgimin të duket “zgjidhja më e lehtë” praktikisht, edhe kur nuk është juridikisht e domosdoshme.

6. Zgjidhjet: detyra të qarta për ligjvënësin, policinë, prokurorinë dhe gjykatat

Siguria publike nuk mbrohet duke e kthyer paraburgimin në rutinë. Ajo mbrohet duke e përdorur paraburgimin vetëm kur është realisht i domosdoshëm, me arsyetim të kontrollueshëm. Zgjidhja nuk vjen nga retorika, por nga disiplinimi i praktikës në secilën hallkë.

Ligjvënësi duhet të veprojë me maturi. Ashpërsimi i pandërprerë i dënimeve dhe kriminalizimi i veprave të lehta rrisin mbingarkesën në të gjithë zinxhirin penal dhe e shtyjnë paraburgimin të përdoret si reagimi i parë, pothuajse automatik. Në të njëjtën kohë, kuadri ligjor dhe mjetet për masat alternative duhet të forcohen realisht - jo vetëm “në letër” - me mekanizma funksionalë monitorimi e zbatimi, në mënyrë që prokuroria dhe gjykata të kenë besim të arsyeshëm se këto masa funksionojnë. Së fundi, ligjvënësi duhet të mbështesë, me politika dhe burime konkrete, reduktimin e vonesave procedurale që e zgjasin paraburgimin, duke synuar përshpejtimin e gjyqimit dhe uljen e ngarkesës strukturore që prodhon zvarritje.

Policia gjyqësore duhet të përmirësojë cilësinë e bazës faktike për pretendimet mbi “rrezikun e ikjes”, “prishjes së provave” dhe/ose “rrezikut të kryerjes së veprave të tjera” duke shmangur formulat standarde. Këto pretendime duhet të mbështeten në të dhëna konkrete si p.sh. sjellje që tregojnë rrezik arratisjeje, tentativa kontakti me dëshmitarë, rrethana reale që lehtësojnë largimin, ose indicie për ndikim mbi provat.

Prokuroria duhet ta paraqes kërkimin për masë sigurimi me arsyetim të individualizuar, të mbështetur në fakte konkrete dhe jo me fraza standarde. Çdo kërkesë duhet të jetë e individualizuar: (i) *cilat fakte tregojnë rrezikun?* (ii) *pse rreziku është aktual?* (iii) *pse alternativat e tjera nuk mjaftojnë?* (iv) *pse paraburgimi është proporcional?* Kjo qasje nuk krijon standard të ri. Ajo zbaton standardin ekzistues të individualizimit dhe proporcionalitetit, që GJEDNJ e kërkon.

Gjykatat kanë përgjegjësinë të veprojnë si “filtër kushtetues e konventor” në kohë reale. Ato duhet të jenë kërkuese; pa individualizim, pa fakte konkrete dhe pa shqyrtim real të alternativave, paraburgimi nuk mund të jetë zgjidhje e paracaktuar. Standardi “Hysa” e ndalon vlerësimin abstrakt (§66); standardi “Gëllçi” e ndalon zgjatjen e paraburgimit vetëm mbi “dyshim të arsyeshëm”, pa arsye të tjera (§19). Të dyja çështjet e ndalojnë refuzimin formal të alternativave të tjera (*Hysa* §76; *Gëllçi* §25). Kjo do të thotë se vendimi duhet të jetë i lexueshëm si një arsyetim i plotë, i ndërtuar mbi faktet e çështjes, vlerësimin konkret të rrezikut, nevojën për masën, testin e proporcionalitetit dhe arsyet pse masat alternative nuk janë të mjaftueshme.

7. Përmbyllje: paraburgimi si barometër i lirisë personale dhe i standardit europian

Paraburgimi është indikator i qartë i mbrojtjes së lirisë personale dhe i cilësisë së kontrollit gjyqësor. Kur paraburgimi bëhet rregull, liria si parim dobësohet, prezumimi i pafajësisë zbehet dhe rreziku i shkeljeve kushtetuese e konventore rritet. Kur paraburgimi rikthehet në natyrën e tij, si përjashtim i domosdoshëm, i individualizuar, proporcional dhe i mbështetur në prova, drejtësia rrit legjitimitetin dhe vendi forcon standardin europian, që i kërkohet.

Në një realitet ku raportohet se 57% e personave në burgje janë në paraburgim, përgjigjja nuk mund të jetë as politizim, as thjeshtim i debatit. Kërkohet qetësi profesionale dhe disiplinë në zbatim. Konventa është e qartë: nuk pranon rreziqe abstrakte, nuk lejon alternativat të trajtohen formalisht dhe nuk toleron zgjatjen e paraburgimit “*për inerci*”.

Paraburgimi nuk është tregues force, por tregues standardi. Kur kthehet në rutinë, drejtësia humbet pikërisht atë që duhet të mbrojë: lirinë si parim dhe arsyetimin si garanci. Ky është një test i përditshëm profesional: të vendosim mbi fakte, jo mbi supozime; mbi alternativa reale, jo “në letër”; mbi arsyetim të kontrollueshëm, jo mbi inerci. Vetëm kështu mbrojmë sigurinë publike pa cenuar themelin e shtetit të së drejtës.